

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Frika / *el-Khauf* / الخوف

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Ata ia kanë frikën Zotit të tyre mbi ta dhe bëjnë atë për çfarë urdhërohen.”
(el-Nehl, 50)

Frikë do të thotë të hiqesh nga garancia për siguri¹, kur ta shohësh lajmin (për paralajmërimet e Allahut). Kjo ka tri nivele:

- Frika nga ndëshkimi, që është frika nëpërmjet së cilës konfirmohet besimi². Kjo është frika e masës (shumicës së besimtarëve), që vjen nga të besuarit e paralajmërimeve, nga të qenët i vëmendshëm për shkeljet, dhe nga të qenët vigjilent për përfundimet.³
- Frika nga plani (Allahut) ndërsa i gëzohesh gjendjes së zgjimit, gjë që është e përzier me ëmbëlsi (të besimit).⁴

¹ Ndonjë pararendës i caktuar i shkujdesjes, pandjesisë, indiferencës, dobësimi të përkushtimit fetar dhe plogështisë shpirtërore.

² Sepse mungesa e plotë e frikës nënkupton mungesë të plotë të imanit.

³ Ata që besojnë në paralajmërimet e Allahut dhe të Dërguarit ﷺ të Tij, besojnë në ahiret (përfundimin) dhe njohin peshën e shkeljeve e mangësive të veta, po ashtu do të jenë vigjilentë (do të kenë takvallëk).

⁴ Kjo është frika e njerëzve me gjendje të mirë besimi. Ata ende nuk ndihen të sigurt, derisa ta takojnë Zotin e tyre dhe t'i sigurojnë vendet e tyre në xhenet. Niveli i parë i frikës është ajo që thjesht quhet خوف (frikë), meqë përmban një dozë tmerri që largon personin nga gjynahu; niveli i dytë mund të quhet *khashije* (خشية), që po ashtu hyn në kategorinë e frikës dhe përmban një dozë vetëpërmbytjeje (*sukûn*) e cila u shkon atyre që janë të angazhuar gjallërisht në dëgjueshmëri. Et-Tirmidhi shënoi nga Abdu-Rahmaan bin Sa'id bin Wehb se Aisha tha: “Pyeta të Dërguarin e Allahut për ajetin ‘Ata që japin atë çfarë japin ndërsa zemrat i kanë të frikësuarat ...’ (23:60) se a bëhet fjalë për ata që dehen dhe vjedhin, dhe ai tha: ‘O bija e es-Siddikut, këta janë ata, që agjërojnë, falin namaz, dhe japin sadaka ndërsa kanë frikë se Zoti i tyre s’do t’ua pranojë: ‘Të këtillët ngarendin në punë të mira dhe kryesojnë në këtë.’ (23:61)”

- Ajka e elitës së besimtarëve nuk ndiejnë zyrtësinë e frikës, por vetëm respektin e thellë (*hiibeh*) të lavdit (hyjnor).⁵ Kjo është pika më e lartë në stacionin (shkallën) e frikës. Ky është një respekt i thellë, që haset nga ai i cili përjeton zbulimin gjatë kohës të bisedës së përzemërt. Kjo mbron shikuesin gjatë kohëve të dialogut miqësor (natën) dhe shtrëngon shikuesin me tronditjen e madhësisë (hyjnore).

⁵ *El-Mukarrabûn* (diateza pësore) janë ata, që sillen më afër Zotit të tyre. Ata nuk ndiejnë mjerimin e largësisë. Frika e tyre ka të bëjë vetëm me respektin e thellë (*hiibeh*), të domosdoshëm, që do t'i parandalojë nga tejkalimi i kufijve me Zotin e tyre pasi Ai i lë në praninë e Tij, pra afër Tij.